



Aplikim për vizë me qëllim shërbim vullnetar

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit. Si pasojë do të nevojitet rezervimi i një date të re aplikimi përfshirë periudhat përkatëse të pritjes.

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:

1.	Formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, 2 copë , të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.
2.	Tarifa	gratis
3.	Fotografi pashaporte	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografimin e tretë silleni me vete si element të veçantë.
Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, <u>me 2 fotokopje</u>, në momentin e aplikimit		
4.	Pashaporta e udhëtimit	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
5.	Kontratë / Marrëveshje	Kontratë / Marrëveshje rreth shërbimit të vullnetarizmit tuaj në Gjermani <u>Udhëzim rreth shërbimit vullnetar përfshirë komponentin Veri-Jug:</u> Kontrata juaj duhet të jetë e nënshkruar si nga ju ashtu edhe nga Zyra Federale për Familjen dhe detyrat e shoqërisë civile (BAFzA) si dhe nga zyra, qendra apo misioni që realizon shërbimin vullnetar. <u>Udhëzim rreth shërbimeve vullnetare rinore (Vit Social Vullnetar (FSJ) ose Vit ekologjik Vullnetar (FÖJ)):</u> Kontrata Juaj duhet të jetë e nënshkruar si nga ju ashtu edhe nga zbatuesi apo qendra përkatëse.

		<p><u>Udhëzim rreth Shërbimit Vullnetar Evropian (EFD):</u> Kontrata Juaj duhet të jetë e nënshkruar nga një agjenci kombëtare Erasmus+ Rinia në Veprim dhe organizatës koordinuese. Marrëveshja e vullnetarizmit, ku janë të përshkruara detyrat dhe rezultatet e planifikuara, duhet të jetë e nënshkruar nga organizata koordinuese dhe vullnetari/ja. Organizata pranuese merr përsipër shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit për vullnetarin/en. Krahas kësaj vullnetari do të marrë edhe një shumë mujore si para xhepi në vlerën e aktualisht 110,00 €.</p> <p>Nëse kontrata apo një vërtetim tjetër i lëshuar nga zyra përkatëse nuk përmban informacione rreth akomodimit dhe ushqimit, paraqisni ju lutem dëshmi plotësuese rreth përballimit të kostove të jetesës.</p>
6.	Dëshmi e gjuhës gjermane	<p>Nëse nuk keni njohuri bazë të gjermanishtes duhet që përmes një vërtetimi të zyrës apo organizatës zbatuese të provohet se mund të hiqet dorë nga njohuritë e gjuhës së huaj dhe se ju mund t'i përftoni ato përmes kurseve të gjuhës pas hyrjes në Gjermani.</p> <p>Udhëzim lidhur me shërbimin vullnetar: njohuritë e gjuhës nuk janë kusht pranimi për pjesëmarrjen në Shërbimin Vullnetar Evropian.</p>
7.	Shkresë motivimi e nënshkruar nga aplikuesi	Ju lutemi të paraqisni në mënyrë konkrete arsytet për të cilat dëshironi të bëni shërbimin vullnetar në Gjermani dhe si e keni përzgjedhur institucionin përkatës. Ju lutemi të informoni edhe rreth perspektivave tuaja profesionale pas realizimit të shërbimit vullnetar.
8.	Jetëshkrimi	Paraqisni ju lutem kualifikimin dhe eventualisht veprimtarinë profesionale të deritanishme.
9.	Minorenët	Minorenët kanë nevojë edhe për çertifikatën e lindjes, (çertifikatë shqiptare e pajisur me vulën apostile dhe e përkthyer në gjuhën gjermane) si dhe një deklaratë dakordësie të noterizuar të prindërve / personit kujdestar për largimin me qëllim shërbimin vullnetar.

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen nga Ambasada dokumenta të caktuara të papërmendura më sipër.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.